

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit BSc në “Teknologji Informacioni”

Ofruar nga Universiteti Privat “ Albanian University”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.Dr. Thoma KORINI

Prof.Asoc. Olimpjon SHURDI



Qershor / 2018

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për programin e studimit BSc në “Teknologji Informacioni”

	Tabela e të dhënave për programin e studimit	
1	IAL Aplikues:	Albanian University
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër Nr. 33, datë 31.01.2012
4	Urdhëri/VBA e Akreditimit të parë	VBA Nr. 43, datë 19.05.2017
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në “Teknologji Informacioni”
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë i studimit
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vjet
8	Kreditet në total (ECTS):	180
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Numri i studentëve për këtë program	21*

*Numri i studentëve i përket vitit akademik 2017-2018

HYRJE

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u kontraktua nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për të bërë vlerësimin e jashtëm të Programit të Studimeve Bachelor në "Teknologji Informacioni" të ofruar nga Albanian University, në kuadër të akreditimit periodik. Qëllimi i procesit të vlerësimit të jashtëm është të japë një mendim të pavarur për shkallën në të cilën institucioni në fjalë është i përgatitur dhe i angazhuar të përmbushë me efektivitet dhe përgjegjshmëri kërkesat dhe standardet akademike të diplomave që do të lëshojë. Për të arritur në këtë gjykim, GVJ u mbështet në shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin bazë mbi të cilin ngrihet veprimtaria e Universitetit (statuti, rregullorja, etj), dosjen e programit të studimit, regjistrat bazë të përcaktuar nga udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), dokumentacionin e zyrës së burimeve njerëzore, takimet e vizitat e organizuara në institucion etj. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e sillabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kompetencën e stafit pedagogjik, etj. Në mënyrë të veçantë vlerësimi u fokusua në plotësimin e rekomandimeve pasqyruar në Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 43, datë 19.05.2017 [Evidencë L1-9].

Albanian University e ushtron aktivitetin e tij bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe të akteve të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë, Statutin e Universitetit, Rregulloren bazë të tij dhe të akteve të tjera rregullatore të institucionit. Albanian University fillimisht është hapur si shkollë e lartë universitare jopublike "Ufo Dental" me VKM nr.197, datë 10.04.2004. Me VKM Nr. 597, datë 28.05.2009 Emërtimi dhe emri i shkollës së lartë universitare, private "UFO dental", ndryshon në Universiteti privat "Ufo University"

Albanian University, aktualisht përbëhet nga tre njësi kryesore: **Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore**. Ai ofron programe studimi për të tre ciklet e studimit si dhe realizon kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar me anë të njëjve përbërëse kryesore, bazë dhe ndihmëse.

Departamenti i Inxhinierive ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2010 me emërtimin Departamenti i Elektronikës, si pjesë e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierive [Evidencë L1-4].

Në vitin 2014, Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierive u bashkua me Fakultetin e Ekonomisë [Evidencë L1-5], duke u riorganizuar në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe në vijim në vitin 2016 në **Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike** [Evidencë L1-7] me 3 departamente:

1. Departamenti i Arkitekturës,
2. **Departamenti i Inxhinierive,**
3. Departamenti i Shkencave Ekonomike.

Departamenti i Arkitekturës dhe Departamenti i Inxhinierive zhvillojnë aktivitetin e tyre në godinën e Rrugës së Kavajës, ndërsa Departamenti i Shkencave Ekonomike në godinën qendrore të Universitetit (Blv. Zogu i I-rë). Programi i studimit **Bachelor në "Teknologji Informacioni"** në Albanian University, është licensuar me urdhër Nr.33, datë 31.01.2012 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës [Evidencë L1-8]. Ky program ka për qëllim që nëpërmjet përgatitjes teoriko – praktike gjatë periudhës 3 vjeçare tu krijojë mundësi studentëve të integrohen në tregun e punës dhe ofron bazat e nevojshme për të thelluar studimet më pas në programin Master i Shkencave në Teknologji Informacioni. Ky program studimi i ka kaluar Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në bazë të Urdhërit Nr. 52, datë 05.02.2016. Në Maj 2017 [Evidencë L1-9], ky program studimi

kaloi akreditimin e parë vetëm për studentët e rregjistruar nga viti akademik 2010-2011, me kohëzgjatjen prej 6 muaj, me afat përfundimi të vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit deri më 18.11.2017. Në RVB [Evidencë L1-2] dhe dokumentacionin mbështetës janë pasqyruar hapat e ndërmarra nga AU në përgjithësi dhe Departamenti i Inxhinierive në veçanti për përmirësimin e elementëve të pasqyruar në rekomandimet e Bordit të Akreditimit.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof.Dr. Thoma KORINI
Prof.Asoc. Dr. Olimpjon SHURDI

Menaxhere vlerësimi e kësaj procedure është specialistja e ASCAL Znj. Majlinda Demirneli

Më datë 04.06.2018 me shkresë zyrtare me Nr. 71/14 Prot me lëndë:” Dërgohen Draft Raportet e Vlerësimit të Jashtëm”, AU është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. AU përcjell në ASCAL, më datë 05.06.2018 me shkresë zyrtare me Nr. 180/3 Prot me lëndë “Kthim përgjigje shkresës nr. 71/14 Prot, datë 04.06.2018 ”kommentet në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, ku AU shpreh dakortësinë me përmbajtjen e këtij drafti. Në këtë mënyrë drafti mer formën e raportit përfundimtar.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA BA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË (VBA Nr. 43, date 19.05.2017)

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit:

- a) Të përmirësohet cilësia e studentëve të pranuar në këtë program studimi;
- b) Të shtohet aktiviteti shkencor i Departamentit;
- c) Të shtohet bashkëpunimi me punëdhënës lokalë me qëllim kryerjen e praktikave të studentëve në institucione të specializuara në fushën e teknologjisë së informacionit;
- d) Të rritet bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë brenda vendit.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

Rekomandimi a) Referuar RVB [Evidencë L1-2]¹, dokumentacionit shtesë [Evidencë L3-3] si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se ka një përmirësim në cilësinë e studentëve të pranuar në vitin e parë. Në këtë mënyrë është arritur që në vitin e parë të vitit akademik 2017 – 2018 nota mesatare hyrëse të jetë 7.01 [Evidencë L3-3], notë kjo në rritje krahasur me dy vitet e mëparshme. Nga analiza e RVB dhe takimet e zhvilluara në institucion, ky përmirësim i atribuohet kryesisht faktit që VKM Nr. 407, datë 01/06/2016, ka vendosur si notë minimale mesatare pranimi për ciklin e studimeve Bachelor notën 6.

¹ Referimi në evidencia bëhet duke dhënë emërtimin e listës (L1, L2, apo L3) të ndjekur nga numri rendor i atribuar në AMS -ASCAL MANAGEMENT SYSTEM

Rekomandimi b) GVJ ka arritur në përfundimin se nga ana e Departamentit të Inxhinierive janë bërë përpjekje sinjifikative në drejtim të rritjes së aktivitetit kërkimor nëpërmjet nxitjes dhe mbështetjes së stafit konkretizuar në aplikime në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare [*Evidencë L1-23, L1-24, L1-25, L1-26*]. Nga takimet me studentët, pedagogët dhe shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se karakteristikë e aktivitetit kërkimor të Departamentit të Inxhinierive është dhe përfshirja në të e studentëve [*Evidencë L1-16, L1-17, L1-18, L1-19, L1-20, L1-21*]. Çdo vit është planifikuar zhvillimi i konferencës studentore. GVJ konstaton se në të gjitha këto veprimtari AU ka vendosur në dispozicion jo vetëm logjistikën, por edhe mbështetjen e nevojshme financiare. Vazhdimësia e procesit të rritjes dhe diversifikimit të aktivitetit kërkimor mbetet një sfidë për vitet në vijim me qëllim konsolidimin e këtij aktiviteti në shërbim të formimit inxhinierik të studentëve dhe rritjes së shkallës së kualifikimit të personelit akademik.

Rekomandimi c) GVJ konstaton se gjatë vitit akademik 2017 – 2018, Departamenti i Inxhinierive ka nënshkruar 7 marrëveshje të reja në kuadër të praktikave mësimore, 4 prej tyre janë të orientuara në fushën e teknologjisë së informacionit [*Evidencë L1-97*]. Mbi bazën e marrëveshjeve të nënshkruara, nga ana e Departamentit të Inxhinierive përcaktohen institucionet ku do të kryhen praktikat si dhe pedagogët udhëheqës [*Evidencë L1-40*]. Nga takimet e zhvilluara në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Departamenti i Inxhinierive ka përcaktuar si një nga objektivat e tij zhvillimit zgjerimin e marrëveshjeve me biznese vendase në kuadër të praktikave mësimore [*Evidencë L1-29*]. Rekomandohet zgjerimi i marrëveshjeve bashkëpunuese për qëllimin e zhvillimit të praktikave edhe të projekteve, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të punojnë me teknologjinë e përditësuar në të ardhmen.

Rekomandimi d) GVJ konstaton se AU ka adresuar problemin e disponibilitetit të personelit akademik me kontratë për të garantuar angazhimin e tyre në vazhdimësi. Në këtë mënyrë, për të minimizuar riskun e mungesës së disponibilitetit të PAK (edhe për efekt të pengesave, vonesave apo edhe mungesës së vullnetit të institucioneve e arsimit të lartë në të cilat këta pedagogë janë të angazhuar me kohë të plotë për lidhjen e kontratave me AU), nga ana e AU janë nënshkruar marrëveshje me 5 institucione të arsimit të lartë në vend me të cilat Departamenti i Inxhinierive ka shkëmbim të drejtëpërdrejtë stafi ose bashkëpunim në kuadër të eventeve të përbashkëta [*Evidencë L1-98, L1-99, L1-100, L1-102, L1-103*] si dhe një marrëveshje bashkëpunimi me një institucion arsimor në Kosovë [*Evidencë L1-101*]. Këto marrëveshje kanë për qëllim jo vetëm krijimin e bazës për shkëmbimin e personelit akademik por dhe t'i shërbejnë zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta si konferenca shkencore, pjesëmarrje në projekte etj.

Në konkluzion, **rekomandimet** e Bordit të Akreditimit janë **plotësuar** dhe i kanë shërbyer përmirësimit të cilësisë së aktivitetit mësimor dhe kërkimor në shërbim të Programit të Studimit Bachelor në “*Teknologji Informacioni*” të AU.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni.

Programi i studimit “Bachelor në Teknologji Informacioni” organizohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike nën përgjegjësinë e Departamentit të Inxhinierive, në bashkëpunim me Departamentet e tjera mësimore të AU, si dhe me institucione me të cilat AU ka marrëveshje bashkëpunimi.

Misioni dhe objektivat e programit të studimit janë të integruara në misionin dhe objektivat e AU i cili synon:

- Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies;
- Të ofrojë programe të studimeve në të tre ciklet e studimit;
- Të zhvillojë punë shkencore në të gjitha fushat që mbulon dhe të përgatisë specialistë dhe shkencëtarë të rinj;
- Të realizojë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese;
- Të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimiti i lartë gjatë gjithë jetës;
- Të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;
- Të kontribuojë në rritjen e standarteve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri bashkëkohore;
- Të ofrojë shërbime, në përputhje me misionin e tij;
- Të mbështesë dhe realizojë aftësimin e personelit akademik, duke i garantuar mundësi të barabartë për të përfituar nga financimet për kërkim shkencor.

AU aspiron përmbushjen e misionit të tij arsimor në frymën e lirisë dhe të respektit të dinjitetit human, pluralizmit të ideve, transparencës së procedurave si dhe promovon mendimin e lirë të pedagogëve dhe studentëve duke u siguruar mundësi të barabarta për studim dhe punësim.

Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” ka për qëllim të hedhë bazat shkencore dhe përgatitjen teoriko-praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si inxhinier në fushën e teknologjisë së informacionit apo dhe në sektorë të tjerë të ngjashëm inxhinierikë.

Objektiva të përgjithshëm [Evidencë L1-28, faqe 1]:

1. Ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimet e Institucionit dhe strategjinë për zhvillim të tij;
2. Është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare;
3. Ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij;
4. Është i organizuar në module dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);
5. Synon pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme.

Objektiva specifike [Evidencë L1-28, faqe 2]:

1. Gjatë vitit të parë akademik programi i studimit “Bachelor në Teknologji Informacioni” ka si synimin t’iu ofrojë studentëve njohuri të përgjithshme të mbështetura në lëndë të formimit bazë të karakterit shkencor.
2. Gjatë 2 viteve të tjera akademike, studenti do të thellojë njohuritë që përkojnë me profilin e diplomës “Bachelor në Teknologji Informacioni”. Në këtë kuadër vendosen objektiva

specifikë për përgatitjen e ekspertëve të aftë për të operuar në këtë fushë, por edhe për të qënë të aftë të integrohen në institucione me karakter specifik në fushën përkatëse.

3. Qëllimi i kësaj kurrikule është t'u ofrojë studentëve njohuri të cilat do të jenë të nevojshme edhe për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit dhe në të njëjtën kohë t'u përgjigjet kërkesave me të cilat do të përballen studentët gjatë realizimit të tyre profesional.
4. Në përfundim të këtij programi studentët duhet të zotërojnë kapacitetet analitike dhe konceptet e nevojshme për të trajtuar problematikat e ndryshme inxhinierike duke u pajisur dhe me shprehje të veçanta të lidhura me fushën përkatëse të studimit.

Mundësitë e punësimit për të diplomuarit në këtë program studimi paraqiten si më poshtë:

- Në institute e laboratorë ku ka aparatura elektronike të ndryshme në të cilat përpunohen informacione të ndryshme të çfarëdo lloji qoftë;
- Në firma të ndryshme private të pajisura me sisteme elektronike si telekomunikacion, industri, ekonomi administratë etj.

Objektivat e zhvillimit të Departamentit të Inxhinierive për vitin akademik 2017 – 2018 janë si më poshtë [Evidencë L1-29, faqe 1]:

- Hapja e programeve të reja studimi në përputhje me nevojat e tregut;
- Kualifikimi i mëtejshëm i të diplomuarve;
- Mobiliteti i stafit akademik dhe administrativ;
- Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit
- Zgjerimi i marrëveshjeve me biznese vendase në kuadër të praktikave mësimore.

Kërkimi shkencor në planin strategjik synon: [Evidencë L3-13, faqe 2]

- Ti krijojë mundësi stafit akademik dhe studentëve për të zhvilluar kërkimin e tyre shkencor.
- Ti shërbejë ngritjes së nivelit të mësimdhënies dhe zhvillimit akademik të brendshëm në Universitet në mënyrë që studentët dhe pedagogët të jenë promovuesit e një kulture nxitëse, bazuar në parimet e të menduarit kritik.
- Të japë kontributin e tij për thellimin e njohurive dhe dijeve njerëzore si edhe aplikimeve të tyre profesionale në vend.
- Të bëjë të mundur një impakt mbi shoqërinë, ekonominë, etj. dhe më tej duke i transferuar njohuritë e zhvilluara më gjerë se sa komuniteti akademik i brendshëm në Universitet.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Programi i studimit Bachelor “Teknologji Informacioni” është plotësisht në përputhje me qëllimet dhe misionin e Albanian University
Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;	Me objektiva të përcaktuar qartë, formimi gjatë periudhës tre vjeçare u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet dhe për të përfituar kompetenca më specifike mbi tema më të profilizuara që mund të trajtohen gjatë studimeve të specializuara në programet e ciklit të dytë
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Ky program studimi ka për qëllim formimin e të diplomuarve me baza të mira teorike dhe me bagazh të

<p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>mirë praktik për integrimin në tregun e punës në fushën e Teknologjisë së Informacionit.</p> <p>Programi i studimit Bachelor “Teknologji Informacioni” i përgjigjet kërkesave të kohës për rritjen e rolit të teknologjisë së informacionit në gjithë aspektet e jetës së përditshme dhe është në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. Programi i studimit është hartuar dhe azhurnohet në përputhje me nevojat e tregut të punës</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “Teknologji Informacioni” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij</p> <p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor “Teknologji Informacioni” është hartuar në mënyrë të tillë që të përmbajë elementët bazë teorikë (kryesisht në dy vitet e para) të nevojshëm për përgatitjen e specialistëve me një bagazh të gjerë, të kompletuar për tu aftësuar në vijim në drejtim të formimit më të specializuar në fushën e teknologjisë së informacionit.</p>
<p>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</p> <p>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Për të mundësuar formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të AU, Departamenti i inxhinierive inkurajon që disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike [Evidencë L1-28, faqe 4]. Kjo bazuar në një studim tregu, si nevojë për përshtatjen me legjislacionin në fuqi, por edhe për të reflektuar kërkesat e personelit akademik apo edhe studentëve.</p> <p>GVJ konstaton se AU i kushton vëmendje të veçantë orientimit të studentëve drejt aftësimit praktik [Evidencë L3-1, faqe 12].</p> <p>Programi i propozuar i studimit favorizon një përgatitje teknike dhe bazë solide në të gjitha fushat e lidhura me teknologjinë e informacionit. Institucioni bazohet në zhvillimet e shpejta të teknologjisë së informacionit në dekadat e fundit dhe prioritetet kombëtare në këtë drejtim si dhe në studime të detajuara tregu [Evidencë L1-27].</p>
<p>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por kontribuon direkt në përgatitjen e specialistëve të cilët me kompetencat e tyre, do të punojnë për zhvillimin e modernizimin e vendit.</p> <p>Programi i studimit, megjithëse nuk ka të bëjë direkt me fushën e ruajtjes së vlerave kombëtare, mbështet zhvillimet prioritare të kohës në Shqipëri e më gjerë.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, misionin, objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të Albanian University si dhe kërkesat e tregut të punës për specialistë të aftë në fushën e teknologjisë së informacionit.

Standartet plotësohen plotësisht

2. Struktura akademike e Fakultetit dhe Departamentit (përgjegjës për programin e studimit)

Albanian University, pas riorganizimit të kryer me Urdhër Nr.52, datë 5.02.2016 të MAS, përbëhet nga tre njësi kryesore:

1. Fakulteti i Shkencave Shoqërore;
2. **Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike;**
3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore

Ai ofron programe studimi për të tre ciklet e studimit si dhe realizon kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar me anë të njërive përbërëse. Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” është organizuar nën drejtimin e Departamentit të Inxhinierive, të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike [Evidencë L2-18, neni 6].

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përbëhet nga tre Departamente sipas skemës organizative në vijim [Evidencë L2-32, neni 14, Evidencë L1-31, faqe 3]:



Organigrama e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike

Fakulteti drejtohet nga Dekani. Sipas Statutit, Dekani i Fakultetit propozohet nga Rektori dhe emërohet nga Senati Akademik mbi bazë të një procesi konkurimi [Evidencë L2-32, Neni 29]. Senati Akademik përbëhet nga 19 anëtarë, nga të cilët 18 janë përfaqësues të personelit akademik dhe 1 përfaqësues i studentëve [Evidencë L2-32, Neni 19]. Në Rregulloren e AU përcaktohen raportet e përfaqësimit të personelit akademik nga secili fakultet [Evidencë L2-37, neni4, pika 4]. Anëtarët e senatit zgjidhen nga Asambleja e personelit akademik.

Organ kolegjal drejtues i Fakultetit është Dekanati, i cili drejtohet nga Dekani dhe përbëhet nga Dekani, Zv.Dekani, Administrator i Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e departamenteve [Evidencë L2-33, neni 9]. Organ tjetër kolegjal i Fakultetit është Asambleja e personelit akademik e cila

përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i Fakultetit dhe ka si funksione [Evidencë L2-33, neni 8]:

- zgjedh anëtarët e personelit akademik, të cilët do të përfaqësojnë njësinë kryesore në Senatin Akademik të AU;
- i propozon Senatit anëtarë nga personeli akademik që do të jenë pjesë në komisionet e përhershme të AU;
- propozon programe të reja studimi ose kërkimi shkencor, hapje, ndryshim ose mbyllje departamentesh ose njësisish të tjera;
- shqyrton dhe miraton raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore dhe Kërkimin Shkencor;
- i propozon Senatit Akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikëqyr realizimin e tij.

Fakulteti në vitin aktual akademik 2017-2018 ka në përbërjen e tij **122** personel akademik efektiv dhe me kontratë. Personel Akademik Efektiv (PAE) janë gjithsej **67** persona, nga të cilët **32** janë me tituj/grada, ndërsa Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë gjithsej **55**, nga të cilët **43** me tituj/grada. **(sipas Tabelës nr. 1 në Anekse)**

Departamenti i Inxhinierive, në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike të AU është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore [Evidencë L2-18, neni 4]. Objektivat Departamentit të Inxhinierive lidhen me objektivat dhe veprimtaritë formuese të programeve të cikleve përkatëse të studimit, të cilat synojnë të arrijnë [Evidencë L2-18, neni 5]:

- nxitjen dhe koordinimin e aktiviteteve mësimore-kërkimore edhe midis departamenteve, por pa prekur lirinë akademike të personelit akademik;
- bën propozimin për hapjen, riorganizimin ose mbylljen e programeve të studimit që ofron;
- zhvillimin e aktiviteteve kërkimore, konsulta mbi kontrata apo pjesëmarrje në projekte të jashtme kërkimore-shkencore;
- në bashkëpunim edhe me departamente të tjera, harton programet për kurse formimi/programe studimi etj., duke saktësuar mënyrën e mbulimit të ngarkesës së tyre;
- kryen studimin e tregut të punës dhe në bazë të tij bën propozime për përmirësimin ose/dhe përshtatjen e kurrikulave dhe programeve të studimit që ofron.

Departamenti i Inxhinierive kryen mbarëvajtjen e procesit mësimor në dy ciklet e studimeve [Evidencë L2-18, neni 6]:

Cikli I:

- Bachelor Inxhinieri Elektronike (180 kredite);
- Bachelor Inxhinieri Kompjuterike (180 kredite);
- **Bachelor Teknologji Informacioni** (180 kredite);
- Bachelor Inxhinieri Mekatronike (180 kredite);
- Bachelor Inxhinieri Elektrike (180 kredite).

Cikli i II:

- Master i Shkencave Inxhinieri Elektronike (120 kredite);
- Master i Shkencave Inxhinieri Kompjuterike (120 kredite);
- Master i Shkencave Teknologji Informacioni (120 kredite).

Departamenti i Inxhinierive në vitin aktual akademik 2017-2018 ka në përbërjen e tij **37** personel akademik efektiv dhe me kontratë. Personel Akademik Efektiv (PAE) janë gjithsej **23** persona, nga të cilët **10** janë me tituj/grada, ndërsa Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë gjithsej **14**, nga të cilët **13** me tituj/grada. **(sipas Tabelës nr. 2 në Anekse)**

Riorganizimi dhe struktura aktuale e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe e Departamentit të Inxhinierive ka kontibuar në forcimin e strukturës së Fakultetit duke e përputhur atë me standartet, dhe krijuar mundësitë potenciale në rritjen e peshës së kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit me partnerë si në institucione brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Grupet mësimore të Departamentit të Inxhinierive janë përgjegjëse direkte për mbarëvajtjen e procesit mësimor apo atij kërkimor-shkencor të disiplinave që mbulojnë, për realizimin me cilësi dhe në kohë të planeve dhe programeve mësimore në fuqi.

Departamenti i Inxhinierive është i organizuar në grupe mësimore si vijon [Evidencë L2-18, neni 8]:

- Grupi mësimor i lëndëve të formimit bazë;
- Grupi mësimor i lëndëve të fushës së Inxhinierisë Mekanike;
- Grupi mësimor i lëndëve të fushës së Inxhinierisë Elektrike;
- Grupi mësimor i lëndëve të fushës së Inxhinierisë Elektronike;
- Grupi mësimor i lëndëve të fushës së Inxhinierisë Kompjuterike/Teknologjisë së Informacionit.

Personeli Akademik përbëhet nga pedagogët me kontratë me kohë të plotë (PAE) si dhe personeli akademik i ftuar (PAK). Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në kontratën e punës dhe në rregullore. Personeli Akademik është i angazhuar në mësimdhënie dhe të kërkim shkencor sipas kërkesave dhe standarteve të AU. Personeli akademik mund të angazhohet edhe me punë të tjera të natyrës administrative, në ndihmë të nevojave të Universitetit.

Për vitin akademik **2017-2018** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **26** pedagogë gjithsej, nga të cilët **16** janë PAE, **7** me tituj/grada dhe **10** PAK, **9** me tituj/grada. **(sipas Tabelës nr. 3 në Aneks)**

Raporti PAE/PAK në këtë program per vitin akademik aktual është **16/10**.

Raporti PAE/Totalit te personelit akademik në këtë program per vitin akademik aktual është **16 / 26 = 62 %**.

Të dhëna për kualifikimin e stafit akademik:

Referuar të dhënave të RVB [Evidencë L1-2], të dhënave të mara gjatë vizitës në Albanian University (e që në mënyrë të detajuar pasqyrohen në anekse) si dhe të dhënave të grumbulluara gjatë hartimit të RVJ në Maj 2016 [Evidencë https://www.ascal.al/media/documents/rvj/PS_1240_540.pdf] në vijim pasqyrohen të dhëna të përmbledhura që i korrespondojnë viteve akademike 2014-2015, 2015-2016 dhe 2017-2018.

Viti Akademik	PAE/PAK	Student/PAE	Student/Staf Total
2014-2015	16/51 (0.31)	77/16 (4.8st/1 PAE)	77/67 (1.15st/1 Pedagog)
2015-2016	19/27 (0.70)	97/19 (5.1st/1 PAE)	97/46 (2.1st /1 Pedagog)
2017-2018	16/10	92/16	92/26

	(1.6)	(5 st/ 1 PAE)	(3 st /1 Pedagog)
--	-------	---------------	-------------------

Viti Akademik	Ngarkesa mësimore e realizuar nga PAE dhe PAK			
	PAE në %	PAK në %	Nga PAE me tituj e grada në % e totalit	Nga PAK me tituj e grada në % e totalit
2014-2015	71%	39%	NA	NA
2015-2016 (sem I)	63%	37%	17%	35.3%
2017-2018 (planifikuar)	72%	28%	50%	90%

Nga sa më sipër, duke patur në konsideratë faktin se numri i studentëve për të tre vitet aktualisht është relativisht i kufizuar, rezulton se numri i studentëve për pedagog efektiv (PAE) apo për pedagog me kontratë (PAK) është mjaft i përshtatshëm për zhvillimin normal të programit të studimit. Nga ana tjetër, vërehet një përmirësim i dukshëm i personelit akademik efektiv me tituj e grada krahasuar me vitet e mëparshme. Gjithashtu vërehet një përmirësim i raportit personeli akademik efektiv/personeli akademik me kontratë. Në këtë mënyrë për vitin akademik 2017-2018, personeli akademik me kontratë është më i vogël se ai efektiv, ndërsa ngarkesa që ai përballon përbën rreth 28% të totalit të ngarkesës. Kjo ul shkallën e ekspozimit ndaj riskut të disponibilitetit të personelit akademik me kontratë (që mund të vijë për efekt të pengesave, vonesave apo edhe mungesës së vullnetit të institucioneve të tjera të arsimit të lartë në të cilat këta pedagogë janë të angazhuar me kohë të plotë për lidhjen e kontratave me AU).

Nga një analizë e ngarkesës mësimore planifikuar për personelin akademik të angazhuar në programin e studimit “Teknologji Informacioni” [Evidencë L3-24] rezulton se në mjaft raste ka një ngarkesë të lartë për një numër pedagogësh (që arrijnë deri në mbi 700 orë). Kjo edhe për shkak të angazhimit edhe në programe të tjerë studimi që mbulohen nga Departamenti i Inxhinierive apo edhe nga departamente të tjerë. Gjithashtu numri i lëndëve të zhvilluar nga një pedagog në mjaft raste është shumë i lartë (në ndonjë rast shkon deri në 10 lëndë).

Një situatë e tillë potencialisht mund të ketë ndikim negativ në cilësinë e mësimdhënies dhe në angazhimin e personelit akademik në detyra të tjera si dhe në kërkimin shkencor.

Nga një analizë e tabelave me të dhëna për stafin akademik sipas moshës dhe titujve e gradave, vërehet se përgjithësisht kemi të bëjmë me staf akademik efektiv (PAE) relativisht të ri në moshë (rreth 38% e PAE me tituj e grada është nën 45 vjeç). Një element i tillë është pozitiv për një zhvillim të qëndrueshëm të Departamentit dhe një dinamikë pozitive në drejtim të kërkimit shkencor (aplikimit dhe pjesëmarrjes në projekte kërkimore).

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Senati Akademik i AU me Vendimin Nr.24 datë 13/12/2017 [Evidencë L1-37], ka marrë në konsideratë rekomandimet e Bordit të Akreditimit (Nr.90, datë 20.10.2017) ka kërkuar marrjen e masave të menjëherëshme duke rekrutuar staf efektiv dhe të sigurojë qëndrueshmërinë e tij. Për këtë u vendos shpallja e vendeve vakante për personeli akademik efektiv jo vetëm në fillim të vitit akademik, por edhe përpara fillimit të semestrit të dytë.

Zyra e Burimeve Njerëzore e AU në bashkëpunim me Zyrën Juridike kanë rishikuar paraprakisht përmbajtjen e kontratave të punës të stafit akademik me kohë të plotë (PAE) si dhe me kontratë (PAK) në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë [Evidencë L1-35, 36].

Më konkretisht në kontrata ndryshimet konsistojnë në:

- Të drejtën e stafit akademik me kohë të plotë për të kërkuar një financim nga AU për një aktivitet shkencor brenda ose jashtë vendit ose botim shkencor në fushën që përbën prioritet për njësinë bazë përkatëse;
- Të drejtën e shkëputjes nga angazhimet e institucionit për kryerjen e vitit sabbatik një herë në shtatë vjet me miratimin e njësisë bazë, për periudha kohore deri në një vit, për të punuar për përparimin akademik;
- Për kategorinë Profesor dhe Lektor me kontratë (PAK) është përcaktuar kohëzgjatja pa afat e kontratës së punës, me të drejtë ripërtëritje çdo vit në momentin e paraqitjes së lejes nga punëdhënësi.
- Kontratat e stafit akademik me kohë të plotë (PAE) për të gjitha kategoritë janë me afat të pacaktuar.

Kontratat që nënshkruhen me pedagogët efektivë dhe ata me kontratë administrohen nga zyra e Burimeve Njerëzore e cila është përgjegjëse jo vetëm për arkivimin e dokumentacionit dhe ruajtjen e tij në vite, por edhe për gjenerimin e statistikave vjetore. Në fillim të secilit vit akademik/semestër zyra e burimeve njerëzore bën përditësimin e informacionit mbi stafin akademik.

Nga takimi i realizuar në Zyrën e Burimeve Njerëzore nga GVJ dhe verifikimi i procedurës së rekrutimit për një numër rastesh rezulton se ndiqet procedura e parapërcaktuar për hartimin e kriterëve, ngritjen e komisionit të vlerësimit, rregjistrimin e kandidatëve, intervistimin e tyre, shpalljen e fituesit dhe lidhjen e kontratës.

Një politikë e tillë ka dhënë rezultate pozitive në drejtim të rekrutimit të stafit akademik dhe shërben si një bazë solide për një zhvillim të qëndrueshëm të tij.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Pas shqyrtimit të DVV dhe vizitës në Institucion rezulton se Albanian University i ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e institucionit, parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs shoqëruar me intervistim të kandidatëve [Evidencë L1-30, neni 30].
Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;	Megjithëse në aspektin numerik, personeli akademik i punësuar me kohë të plotë është 16/26 , pra përbën rreth 62% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni, përsa i përket ngarkesës mësimore vërehet se përbën
Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	
Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash	

<p>të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>respektivisht rreth 72% të ngarkesës mësimore totale [Evidencë L3-24].</p> <p>Për ngarkesën e stafit në të gjitha programet e studimit për vitin akademik 2017-2018, në dokumentacionin e sjellë nga institucioni rezulton:</p> <p>Stafi PAE:2 pedagogë mbulojnë 10 lëndë, 1 pedagog mbulon 9 lëndë, 1 pedagog mbulon 7 lëndë, 1 pedagog mbulon 6 lëndë, 2 pedagogë mbulojnë 5 lëndë, 2 pedagogë mbulojnë 4 lëndë, 3 pedagogë mbulojnë 3 lëndë, 1 pedagog mbulon 2 lëndë dhe 3 pedagog mbulojnë 1 lëndë Ngarkesa orë në auditor paraqitet: nga 77 deri në 596 ore.</p> <p>Gjatë shqyrtimit të DVV dhe vizitës në institucion GJV konstatoi se AU ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Për pedagogët, kryhen vlerësime edhe nga studentët si dhe ndiqet progresi i tyre nga ana e Përgjegjësit të Departamentit [Evidencë L2-20, L2-21, L2-22].</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore ka një bazë të dhënash për të gjithë procesin e rekrutimit të personelit dhe njoftimeve për punë.</p>
<p>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore rezultoi se AU ka një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik.</p> <p>AU disponon një informacion të përditësuar për personelin akademik. Për çdo vit akademik përcaktohet safi akademik që do të angazhohet (i ndarë sipas semestrave) dhe lidhen kontratat me PAK.</p> <p>Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik bëhen publike kur vendoset shpallja për pozicion pune të lirë (shpallen nëpërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit, faqes web të AU dhe televizionit të AU).</p> <p>AU angazhon si titullarë të lëndëve, moduleve personel akademik i cili minimalisht ka gradën shkencore Doktor, por titullarë të lëndëve në një pjesë të tyre janë nga personeli akademik me kontratë [Evidencë L3-25].</p> <p>Megjithëse për momentin, personeli akademik me kontratë është i qëndrueshëm, në një perspektivë afatgjatë angazhimi i tyre si titullarë lëndësh paraqet elementë risku.</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizites ne institucion rezultoi se personeli ndihmës akademik (2 anëtarë) i angazhuar për zhvillimin e orëve laboratorike ka kualifikimin e duhur dhe punon jo vetëm në mbështetje të realizimit të procesit mësimor, por edhe për mirëmbajtjen e bazës laboratorike e cila është një bazë laboratorike bashkëkohore. Kryesisht seancat laboratorike kryhen nga personel akademik me përgatitje të plotë për zhvillimin e lëndëve laboratorike, duke punuar me grupe të vegjël studentësh.</p> <p>Personeli akademik është i angazhuar për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Departamenti kontrollon dhe vlerëson punën e tyre nëpërmjet anketimeve të kryera me studentët [Evidencë L2-20].</p>

dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).	Numri i studentëve, deri tani, është relativisht i kufizuar. Në këtë mënyrë nuk ka patur vështirësi përsa i përket personelit të nevojshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e tyre në praktikën profesionale [Evidencë L1-40]. Pozitivisht në zhvillimin e praktikave ka ndikuar edhe lidhja e kontratave me një numër kompanish [Evidencë L1-97].
Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>AU nuk ka organizuar programe kualifikimi specifike të zhvillimit profesional të personelit akademik. Elementë të kualifikimit të mëtjshëm mund të gjenden në aktivitetet shkencore të zhvilluara [Evidencë L1-104] si dhe në trajnimet në kuadër të vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ka të dhëna të plota për programet e studimeve të ofruara prej tij. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm informimi luan faqja e internetit e institucionit (http://albanianuniversity.edu.al/) e cila jep informacionin bazë për gjithë programet e ofruara të studimit.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjatë vitit të fundit akademik ka patur rekrutim të personelit akademik efektiv duke bërë të mundur rritjen e numrit të personelit akademik me tituj e grada si dhe përmirësimin e raportit PAE/PAK. Megjithatë, duke patur parasysh angazhimin e personelit akademik edhe në programe të tjera studimi që mbulon Departamenti, rekomandohet ulja e ngarkesës mësimore si dhe e numrit të lëndëve të zhvilluara nga një pjesë e tyre në kufij të pranueshëm. Kjo mund të realizohet duke vazhduar me procesin e rekrutimeve të PAE. • Megjithëse në aspektin numerik, personeli akademik i punësuar me kohë të plotë nuk përbën 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit, përsa i përket ngarkesës mësimore të realizuar, ajo mbulohet në një masë që e kalon kufirin 70%, në 72% nga personeli akademik efektiv, ndaj mund të konsiderohet që në global ky kriter respektohet. • Personeli akademik me kontratë, paraqet qëndrueshmëri në vite dhe duke qenë personeli i kualifikuar ka treguar përkushtim në realizimin e programit në këto vite të angazhimit të tij. Megjithatë institucioni duhet të ndjekë politika për të garantuar që titullari i lëndëve të jetë nga kategoria e PAE duke synuar në këtë mënyrë edhe në minimizimin e riskut që jep varësia nga personeli akademik me kontratë. • AU ka të dhëna të detajuara përsa i takon personelit akademik të angazhuar, formën e punësimit dhe ngarkesën e realizuar. AU ndjek procedura transparente për rekrutimin e personelit mësimdhënës. Vështirësi paraqiten në rekrutimin e personelit akademik me kualifikimin e kërkuar. <p>Standartet plotësohen kryesisht</p>	

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Departamenti i Inxhinierive si njësi bazë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike zhvillon aktivitetin e tij në godinën e cila ndodhet në adresën “Rruga e Kavajës”. Godina e cila është në shërbim të gjithë programeve të studimit të Fakultetit, ka ambientet e saj të përshtatshme për shvillimin e procesit mësimor (përfshirë edhe seancat laboratorike) si dhe ofron shërbime suplementare si bibliotekë, zyrë informacioni për studentët, mjedis çlodhës (kafeteri), mjedis për fotokopjime, nyje higjeno-sanitare etj. [Evidencë L1-41].

Nga vëzhgimi i ambienteve, GVJ konstaton se ato janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor. Sallat e leksioneve janë të paisura me mjetet e nevojshme didaktike si videoprojektor, ekrane projektimi etj. Mënyra e realizimit të mësimdhënies bazohet në metoda e teknologji bashkëkohore.

Në funksion të programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Inxhinierive, institucioni ka ngritur laboratorët mësimore si më poshtë [Evidencë L1-43]:

- Laboratorët e Informatikës 1 – 2 (Simulimeve),
- Laboratori i Infrastrukturës së Rrjetave,
- Laboratori i Fizikës,
- Laboratori i Kimisë,
- Laboratori i Elektroteknikës,
- Laboratori i elektronikës analoge\laboratori i elektronikës dixhitale,
- Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronike,
- Laboratori i automatikës dhe kontrollit (dhe Mekatronikës),
- Laboratori i makinave elektrike.

Këta laboratorë janë të pajisur me aparatura dhe pajisje bashkëkohore në përputhje me kërkesat e programit të studimeve Bachelor në “Teknologji Informacioni”.

Biblioteka në dispozicion të studentëve të Fakultetit, e cila funksionon në orarin 8.00 - 16.00 nga e hëna deri të premten dhe në orarin 8:00 – 12:00 ditën e shtunë, ofron një numër titujsh për të mbuluar programin e studimit të ofruar. Synohet disponibiliteti i literaturës bazë në gjuhën shqipe, por shfrytëzohen edhe libraritë elektronike të cilat përmbajnë libra apo botime shkencore në drejtim të teknologjisë së informacionit. Përgjithësisht për secilën lëndë apo njësi lëndore, pedagogu i udhëzon studentët për literaturën bazë dhe për literaturën e rekomanduar. Literatura bazë është kryesisht ajo që përdoret edhe në Universitete të tjera publike e private në gjuhën shqipe. Rreth 80% e lëndës është e mbështetur në literaturën bazë [Evidencë L3-1, faqe 5, faqe13]. Në literaturën bazë rekomandohen edhe tekste të përkthyer nga shtëpi të ndryshme botuese, si dhe tekste në gjuhë të huaj. Në çdo rast, pedagogu u ofron studentëve leksionet e tij të shkruara. Literatura ndihmëse është gjithashtu e parashikuar dhe e pasqyruar në syllabusin e çdo lëndë.

Biblioteka e Fakultetit, e cila shërben njëkohësisht edhe si sallë interneti dhe si mjedis për fotokopjime, ka një kapacitet relativisht të kufizuar.

Në bibliotekë gjenden rreth 100 tituj librash në fushat inxhinierike me rreth 300 kopje [Evidencë L1-13]. Vetëm në vitin akademik 2017-2018 biblioteka është pasuruar me 119 kopje [Evidencë L3-11]. Në bibliotekë janë të instaluar 25 terminale të lidhura në një kompjuter qendror, të cilët vihen në dispozicion të studentëve, duke i mundësuar atyre kërkimin në internet dhe aksesimin e librarive *online* [Evidencë L1-14, 15] të këshilluara nga departamenti.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;	Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentet GVI konstatohet se pedagogët u rekomandojnë studentëve tekste mësimore që shërbejnë si literaturë bazë si dhe leksione dhe materiale të tjera ndihmëse. Rreth 80% e lëndës është e mbështetur në literaturën bazë [Evidencë L3-1, faqe 5, faqe13].
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;	Gjatë vizitës tek biblioteka u konstatua se biblioteka e Fakultetit, ka një ambient relativisht të kufizuar hapsinor.
Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe	

<p>programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Synohet disponibiliteti i literaturës bazë në gjuhën shqipe, por shfrytëzohen edhe libraritë elektronike të cilat përmbajnë libra apo botime shkencore në drejtim të teknologjisë së informacionit. Vëmendja e shtuar ndaj bibliotekës, bazuar edhe në rekomandimet e akreditimit të mëparshëm, ka bërë që të ketë një pasurim të konsiderueshëm të saj me tituj në shërbim të programit të studimit [Evidencë L3-11].</p> <p>Bazuar në azhornimet vjetore të programeve të lëndëve nga ana e pedagogëve titullarë, hartohet plani i detajuar (dhe buxheti përkatës) me librat e rinj me të cilët konsiderohet e nevojshme të pasurohet biblioteka [Evidencë L1-42], për t'ju ardhur në ndihmë studentëve dhe për t'i mbajtur të azhornuar me zhvillimet më të fundit të programeve përkatëse.</p> <p>Biblioteka është në dispozicion të studentëve në orarin 8.00 - 16.00 nga e hëna deri të premten dhe 8:00 – 12:00 ditën e shtunë dhe përputhet me oraret e zhvillimit të seancave mësimore.</p>
--	---

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit tëstudimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion GVJ konstatoi se mjediset aktuale janë të përshtatshme dhe me hapësira funksionale për zhvillimin e të gjitha veprimtarive universitare. Ndërtesa e venë në dispozicion të Fakultetit është e pajisur me salla leksionesh, seminaresh, konferencash, laboratorësh të informatikës dhe të inxhinjerisë të nevojshëm për realizimin e programit të studimit [Evidencë L1-2, faqe 13, Evidencë L1-41].</p> <p>Mjediset mësimore janë të paisura me mjetet e nevojshme për një mësimdhënie cilësore në përputhje me qëllimet dhe objektivat e programit të studimit.</p> <p>Laboratorët e nevojshëm për programin e studimit Bachelor në “Teknologji informacioni”, si laborator i Fizikës, laborator i Kimisë dhe Laboratori i elektronikës, Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronike etj., përmbajnë aparatura moderne në shërbim të programit. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ka disa laboratorë në shërbim të programit të studimit.</p> <p>Fakulteti disponon laborator të teknologjisë së informacionit me një numër të konsiderueshëm kompjuterash të paisur jo vetëm me programet bazë, por edhe me software specifike për programin e studimit. Sipas RVB, si dhe nga diskutimet me studentë e pedagogë të programit të studimit rezulton se praktikat profesionale realizohen në mjediset e Fakultetit si dhe në institucione të tjera shtetërore apo private. Janë bërë përpjekje të konsiderueshme për institucionalizimin e tyre nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve përkatëse dhe përcaktimin e personave përgjegjës dhe udhëheqësve të praktikave si nga ana e Departamentit ashtu dhe nga kompania pritëse[Evidencë L1-40, L1-97, L1-105].</p>
---	---

Konkluzione të GVJ:
Mjediset aktuale janë të përshtatshme dhe me hapësira funksionale për zhvillimin e të gjitha veprimtarive universitare. Infrastruktura që është në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standartet dhe kriteret e cilësisë. Godina, disponon një infrastrukturë moderne. Sallat e leksioneve janë të paisura me videoprojektor. Laboratorët e informatikës janë të paisur me programet e nevojshme të përcaktuar në

programin mësimor. Laboratorët mësimorë janë të kompletuar rishtas duke u paraqitur me paisje të reja bashkëkohore për zhvillimin cilësor të seancave praktike.

Biblioteka, ka një kapacitet të kufizuar hapsinor, por megjithëse përgjithësisht ofron kushte të mira. Fond i botimeve ka ardhur duke u pasuruar duke mbuluar në një masë të madhe lëndët me literaturën bazë. Veç kësaj mund të shfrytëzohen edhe bibliotekat on-line si dhe libraritë elektronike të cilat përmbajnë libra apo botime shkencore në drejtim të teknologjisë së informacionit.

Kryerja e praktikave profesionale garantohe duke shfrytëzuar si mjediset e Fakultetit ashtu edhe institucione të tjera shtetërore apo private me të cilat janë lidhur marrëveshje.

Standartet plotësohen plotësisht

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Burimet financiare të universitetit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit. Të gjitha këto të ardhura shkojnë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese. Në rang universiteti ka një njësi e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare, dhe kontrollin e tyre.

Rreth 1/3 e burimeve të të ardhurave shpenzohet për qiranë e objektit dhe shërbime të tjera të lidhura me të (mirëmbajtja, pastrimi, ngrohja, ftohja, etj.) [Evidencë L1-2].

Pjesë tjetër e burimeve të të ardhurave shpenzohet për pagesën dhe sigurimet e punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me reklamën, shërbimin internet, pajisjet e aparaturat, mjetet e konsumit dhe detyrimet ndaj shtetit.

Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistrohen, përpunohen dhe auditohen mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT-i) të lëshuar nga QKR.

Institucioni ka një raport financiar për çdo vit buxhetor të hartuar dhe certifikuar nga ekspertë të jashtëm (audit i jashtëm) [Evidencë L3-8, L3-9, L3-10]. Nga analiza e pasqyrave financiare rezulton se për tre vitet e fundit marrë në konsideratë institucioni rezulton me fitim të qëndrueshëm. Në këtë mënyrë institucioni nga pikpamja financiare garanton zhvillimin e tij perspektiv.

Sipas RVB [Evidencë L1-2, faqe 16], kostoja për një student në programin e studimit *Bachelor* në Teknologji Informacioni është 118800 lekë.

Eventualisht institucioni mund të punojë në drejtim të diversifikimit të burimeve të financimit, duke mos u kufizuar vetëm tek tarifat e shkollimit, por duke ofruar shërbime për të tretët, duke u angazhuar në projekte shkencore si dhe eventualisht projekte zbatimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;	AU bën një audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare, e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik.
Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;	Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet dhe të ardhurat (duke ju referuar bilancit).
Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të	Raporti i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet. Aktualisht universiteti nuk përfiton ndonjë grant të huaj.

lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë tëhollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>AU harton raportin e bilancit të të gjithë shoqërisë çdo vit në të cilin parashikohen të dhëna të hollësishme financiare për të ardhurat. Ky raport disponohet nga zyra e financave të universitetit.</p> <p>AU i ka të dokumentuara raportet financiare për të tri vitet e fundit [Evidencë L3-8, L3-9, L3-10].</p> <p>AU dëshmon një qëndrueshmëri financiare. Eventualisht, në të ardhmen, mund të punohet në drejtim të diversifikimit të burimeve të financimit.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Në mënyrë të përvitshme hartohet një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve; - Çdo vit, AU bën një auditim të jashtëm për sa i përket situatës financiare; - Duke iu referuar raportit financiar zyrtar AU ka një bilanc vjetor pozitiv, i cili garanton ecurinë perspektive të programeve të studimit. - Konstatohet qëndrueshmëri financiare e AU, por eventualisht mund të punohet në drejtim të diversifikimit të burimeve të financimit. <p>Standardet plotësohen plotësisht.</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Mbështetur në dokumentacionin në dosjen DVV dhe gjatë vizitës në institucion rezultojnë se: “Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë” është ngritur dhe funksionon në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar mbi arsimin e lartë si dhe dispozitat e Statutit të AU dhe të Rregullores Mësimore, në institucion është ngritur Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë. Ngritja dhe funksionimi i këtij sistemi rregullohet hollësisht nëpërmjet “Rregullores së brendshme të Universitetit” [Evidencë L1-30 neni 14] si dhe në Rregulloret specifike për sistemin e Sigurimit të Cilësisë. Kjo njësi rezultojnë të jete në varësi të drejtpërdrejtë të Rektorit të Universitetit, dhe ka për detyrë paraqitjen e raporteve semestral dhe vjetor në të cilin përfshihen informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar, si dhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrave të cilësisë në të ardhmen. Në përfundim të çdo semestri akademik, të gjithë studentët e AU ftohen të plotësojnë nëpërmjet sistemit elektronik pyetësorët në lidhje me vlerësimin e pedagogut për çdo lëndë. Përmbajtja e pyetësorëve është standarde dhe konsiston në vlerësimin nga ana e studentit të 11 rubrikave me një interval nga 1 (vlerësimi më i ulët) deri në 5 (vlerësimi më i lartë). Plotësimi i pyetësorit bëhet në mënyrë krejtësisht konfidenciale dhe çdo student është i ftuar të plotësojë pyetësorin. Raporti pasi paraqitet në Senat Akademik, miratohet dhe publikohet në faqen zyrtare web. NjSBC ushtron funksion mbështetës, këshillimor, bashkërendues, monitorues dhe administrativë me strukturat e tjera akademike dhe administrative të Universitetit, si dhe ofron

ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë. Kjo njësi në bashkëpunim me Komisionin për Vlerësim Institucional hartonte politikat e vetëvlerësimit dhe përcakton dhe kriteret e vlerësimit që do të ndiqen, bën të mundur hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese. Gjatë vizitës në institucion na u tha se NjSBC funksionon edhe në nivel njësie bazë prej shtatorit të vitit 2016 me ngritjen e grupeve të Sigurimit të Cilësisë brenda departamentit, me Vendim Senati Akademik Nr. 157/3 dt. 08/09/2016 [Evidencë L1-44]. Detyra kryesore e kesaj njësie ishte që në fillim të çdo viti akademik, gjatë procesit të mësimdhënies, dhe në përfundim të tij të analizohen dhe të vlerësohen programet mësimore, literatura dhe format e vlerësimit. Kontrolli dhe vlerësimi bëhen në bazë të të dhënave statistikore, të mbledhura gjatë anketimeve të studentëve, fokus – grupeve, raporteve të vetëvlerësimit të pedagogëve, raporteve semestrale dhe vjetore të njëjësive bazë, si dhe rezultateve të arritura nga studentët. Këto të dhëna statistikore vihen në dispozicion të NjSBC nga njësia bazë & sekretaria mësimore. NjSBC analizon të dhënat dhe nxjerr në pah çështjet dhe situatat për përmirësim, me qëllim rritjen e performancës së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, ndërveprimit të të gjithë faktorëve përbërës së Universitetit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

▪ Sa anketime kanë bërë me studentët e programit të studimit?

Realizohen 2 anketime në vit me studentët, një në përfundim të semestrit të parë dhe një në përfundim të semestrit të dytë, gjithmonë përpara sezonit të provimeve.

▪ Sa studentë janë anketuar?

Gjatë vitit akademik 2016 – 2017, në semestrin e parë kanë marrë pjesë në anketim 45.2% e studentëve të programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni, në semestrin e dytë kanë marrë pjesë në anketime 30% e studentëve. Gjatë vitit akademik 2017 – 2018 në semestrin e parë kanë marrë pjesë në anketim 49.4% e studentëve të programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni.

▪ Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë?

Të gjithë të dhënat e mbledhura nga pyetësorët janë përpunuar dhe nga analiza e tyre ka rezultuar se, në përgjithësi, studentët janë shprehur pozitivisht. Nga të dhënat e pyetësorëve, nuk vihen re problematika të mëdha lidhur me stafin pedagogjik dhe atë administrativ. Ajo që vlen të theksohet është fakti se në disa raste, asistent-lektorët kanë marrë vlerësime më pozitive sesa lektorët e lëndëve përkatëseve. Kjo, me shumë mundësi pasi grupet në leksione janë shumë më të mëdha, duke e bërë marrëdhënien më pak të drejtpërdrejtë, dhe për vetë përmbajtjen e leksioneve më shumë teorike dhe pothuajse aspak praktike. Vlerësimet e viteve të treta mbeten më pozitive. Studentët janë më të tërhequr nga lëndët e fushave të tyre përkatëse, sesa nga lëndët e formimit bazë. Një pjesë e konsiderueshme e studentëve shprehen se do ta rekomandonin universitetin, falë eksperiencës së tyre pozitive.

▪ Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm?

Rezultatet e pyetësorit janë diskutuar në nivel njësie bazë duke ruajtur konfidencialitetin dhe janë përcjellur në njësitë kryesore, në NjSBC dhe Rektorat. Në semestrat pasardhës është synuar përmirësimi i çështjeve problemore të mundshme që kanë rezultuar nga zhvillimi i pyetësorëve, si

në raport me stafin akademik ashtu edhe në raport me literaturën dhe përmirësimin e shërbimeve universitare në përgjithësi.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Të dhëna për anëtarët e NJSBC janë paraqitur ne Tabelën 5, Aneksat

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik njësia bazë harton raportin semestral dhe në përfundim të vitit akademik raport vjetor, në të cilin përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, dhe në fund paraqitet analiza SWOT, si dhe vendosen detyra për përmirësime në të ardhmen.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Bazuar në raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe në gjendjen e konstatuar gjatë vizitës, AU ka politika të qarta të vlerësimit të mbështetura në standartet e cilësisë. Nuk u evidentuan ndryshime ndërmjet të dhënave të deklaruara dhe atyre të konstatuara.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p>	<p>Pas shqyrtimit të DVV dhe takimit me përgjegjësen e NJSBC gjatë vizitës GVJ konstaton se, AU përdor metodologji vlerësimi për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit, dekanateve dhe njësive bazë të fakulteteve [Evidencë L1-45].</p> <p>Njëherazi rekomandon detyra, zbatimin e të cilave ndiqet nga ana e strukturave dhe vetë NJSBC. Informacioni i përfutur, e që menaxhohet nga NJSBC, bëhet pjesë edhe e raporteve të vetëvlerësimit, pjesë e të cilëve është edhe RVB i programit të studimit Bachelor në TI duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Për çdo Departament hartohet raporti vjetor i monitorimit në të cilin jepet në mënyrë të detajuar edhe plani i veprimit të njësisë. Gjithashtu për çdo lëndë të zhvilluar bëhet vlerësimi i mësimdhënësit duke llogaritur në këtë mënyrë indeksin e performancës.</p> <p>GVJ konstatoi se në institucionin AU ndërmjet NJSBC dhe njësive bazë kryen në mënyrë të rregullt vlerësimi i veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodave të ndryshme, si</p>

<ul style="list-style-type: none"> a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); b. Dëgjime në auditor; c. Vlerësimi me nota/pikë; d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; g. Etj. 	<p>vlerësimeve kolegu-për-kolegun, raporteve semestrale për saktësinë, transparencën, audibilitetin e vlerësimeve të studentëve nga pedagogët, raportet fund-vjetore për ecurinë e vitit akademik [Evidencë L1-46].</p> <p>Rezultatet e tyre vihen në dispozicion të drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe gjejnë reflektimin e tyre në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit u transmetohen pedagogëve në trajtën e një përpunimi statistikor. Në mënyrë sistematike nga ana e sektorit të statistikave përpunohen të dhënat mbi rezultatet e studentëve në studimet e tyre në AU kalueshmëria për lëndë dhe pedagogë, etj.</p>
---	--

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Albanian University ka kryer procedurat e akreditimit institucional dhe bazuar në Vendim e Bordit të Akreditimi nr. 90, dt. 20/10/2017 institucioni është akredituar për një kohëzgjatje 2 vjeçare.</p> <p>Vendim i Bordit të Akreditimi nr. 90, dt. 20/10/2017.</p> <p>Njësitë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë të programit Bachelor në Teknologji Informacioni përdorin instrumentet të shumëllojshme për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi cilësinë.</p> <p>Institucioni ka një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik, çdo vit, nëpërmjet raporteve të vlerësimit dhe pyetësorëve në çdo fund semestri [Evidencë L1-44].</p> <p>Programet e studimeve dhe syllabuset rishikohen çdo fillim viti akademik, me pjesëmarrjen e grupeve të sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë. Theksi vihet në përditësimin me literaturë bashkëkohore, ndryshimet në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Kjo realizohet në bashkëpunim edhe me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisionin për Mësimin dhe Kurrikulat.</p> <p>Institucioni në fillim të çdo viti akademik në javët orientuese sqaron studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. Avantazhet dhe disavantazhet që kanë këta të fundit nga vlerësimi cilësor dhe akreditimi i programeve të studimit dhe vlerësimi institucional.</p>
---	---

Institucioni ka gjithmonë në vëmendjen e tij përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore - shkencore që ofron. Sigurimi i cilësisë është pjesë e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të Universitetit, pika 7. Strategjia është e publikuar në faqen zyrtare të AU.

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në raportin e vetë vlerësimit dhe vizitës në institucion rezultoi se, në AU sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është ngritur dhe ka funksionuar me të gjitha strukturat në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Kështu në nivel njësie bazë siç është departamenti, analizohen programet mësimore, literatura, sisteme të vlerësimit, para çdo fillimi të vitit të ri akademik dhe në vazhdim të tij. Nga ana e GVJ u konstatua se në fakultet janë institucionalizuar elementë të sistemit të sigurimit të cilësisë, është ngritur dhe funksionon një sistem i plotë i dokumentuar që të garantojë sigurimin e cilësisë në të gjitha aktivitetet e tij, në përputhje me standartet përkatëse. GVJ dëshiron të vërë në dukje se nga bisedat me drejtuesit e departamenteve dhe me stafin akademik në tërësi, u evidentua dëshira institucionale për nevojën e përpunimit të vazhduar të proceseve të garantimit të cilësisë. Prania e një kulture institucionale të vlerësimit kritik të vetvetes nëpërmjet organizimit të vlerësimeve të brendshme dhe planifikimit të përmirësimeve të nevojshme, që GVJ e gjeti të shprehur në prova dokumentare, janë garanci për qasjen objektive të institucionit ndaj menaxhimit të cilësisë tani dhe në të ardhmen.

Standardet plotësohen plotësisht

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni ka për qëllim të hedhë bazat shkencore dhe profesionale në përgatitjen teorike-praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si inxhinier në fushën e sistemeve të informacionit dhe rrjetave kompjuterike.

Kjo përgatitje e përgjithshme gjatë periudhës trevjeçare u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet dhe për të përfunduar kompetenca më specifike mbi tema më të profilizuara që mund të trajtohen gjatë studimeve të specializuara. Programi, ka për qëllim t'i përgatisë studentët si specialistë për të punuar në sektorë të tjerë të ngjashëm inxhinierikë duke thelluar njohuritë e tyre në fusha të tjera inxhinierike.

Programi i studimit ka për qëllim të krijojë një profil të mirë të studentit të diplomuar, i cili do të jetë i aftë që nëpërmjet procesit të përfitimit të njohurive dhe vlerësimit, të zhvillojë një sërë shprehish dhe kompetencash, si:

- a) Aftësinë për të zhvilluar veprimtarinë në institucione e firma të ndryshme ku ka sisteme elektronike informacioni;
- b) Pa një periudhe stazhi në profesion, aftësinë për të drejtuar kualifikimin apo edhe përgatitjen e kuadrove të ardhshëm në këtë fushë.

Shpërndarja e krediteve sipas disiplinave është si më poshtë:

1. Disiplinat e formimit të përgjithshëm plotësojnë 44 ETCS ose 24.5 % të programit të përgjithshëm.
2. Disiplina të formimit karakterizues plotësojnë 85 ETCS ose 47.2 % të programit formues.
3. Disiplinat formuese të ngjashme ose integruese me disiplinat karakterizuese plotësojnë 14 TCS ose 7.8 % të programit formues.
4. Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët plotësojnë 9 ECTS ose 5 % të programit.
5. Disiplinat e veprimtarisë formuese, për gjuhë, informatikë dhe praktika plotësojnë 22 ETCS ose 12.2 % të programit të formimit.
6. Provimi i diplomës plotëson 6 ETCS ose 3.3 % të strukturës Bachelor.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni është liçensuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 33, datë 31/01/2012 Ky program është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit, VBA nr. 43, datë 19.05.2017, për një kohëzgjatje 6 mujore.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit është i organizuar në minimumi 3 vite akademike.

- Viti akademik ka 30 javë mësimore. Viti akademik ndahet në dy semestra, semestri i parë (I) dhe semestri i dytë (II). Secili semestër ka 15 javë mësimore.
- Gjatë vitit të parë akademik organizohen tre sesione provimesh. Në vitet e tjera akademike organizohen pesë sesione provimesh të përcaktuara në kalendarin akademik të çdo programi mësimor dhe tre sesione diplomimi.
- Me vendim të Senatit Fakultetet mund të organizojnë edhe sesione të tjera të kufizuara të provimeve të bartura (riprovime), jashtë kalendarit akademik, para përfundimit të semestrit të parë dhe semestrit të dytë.
- Plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), lëndët dhe modulet vlerësohen nga kreditet sipas parimit 1 kredit përfaqëson 25 orë punë mësimore. Në orët përcaktuese të kreditit përfshihen, përveç orëve mësimore në auditor, edhe koha jashtë auditorit e nevojshme për përvetësimin e materialit mësimor të dhënë, për përgatitjen e detyrave si dhe koha për punë të pavarur të studentit. Llogaritja e krediteve bëhet sipas koeficienteve orientues të miratuar nga MAS.
- Kreditet mundet të fitohen, të sigurohen, të akumulohen ose të transferohen, nga studenti. Kreditet e një lënde fitohen, kur vlerësimi në atë lëndë është kalues. Nga brenda Universitetit janë të transferueshme të gjitha kreditet e fituara; nga jashtë tij transferimi i krediteve kryhet sipas një rregulloreje të veçantë.
- Kreditet e një lënde nuk sigurohen kur studenti ka plotësuar kushtet e frekuentimit dhe nuk është vlerësuar jokalues në detyrat e testet e kontrollit të zhvilluara gjatë semestrit, por, për arsye të ndryshme ende nuk është provuar në atë lëndë ose vlerësimi i plotë pas provimit të dhënë të lëndës është jo kalues.

- Kreditet e një lënde akumulohen kur studenti i ka siguruar, por ato ose nuk janë të mjaftueshme ose studenti nuk dëshiron të provohet në atë lëndë atë semestër apo atë vit. Këto kredite akumulohen edhe në rastin e ndërprerjes së studimeve për arsye vetjake ose familjare objektivisht të pranueshme.

Një vitë akademik konsiderohet i kryer kur studenti ka fituar jo më pak se 60 kredite. Për përfundimin e studimeve të Ciklit të Parë studentit i duhet të fitojë minimalisht 180 kredite.

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë(sipas RVB)**

PLANI MËSIMOR për programin e studimit BSc. në Teknologji Informacioni			
Tipi i Veprimtarisë (A-F)	Lënda/Moduli	ECTS	Totali
Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A)	Fizika (1 - 2)	9	44
	Analizë matematike (1 - 2)	11	
	Kimi	4	
	Algjebër - Gjeometri, Probabilitet dhe statistikë	9	
	Ekonomia e ndërmarrjeve elektrike	4	
	Analizë komplekse, Analizë numerike	7	
Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B)	Elektroteknika 1, Hyrje në eksperimentim laboratorik	9	85
	Elektroteknika 2, Komunikimi numerik	9	
	Elementë e teknologji elektronike	5	
	Matje elektrike dhe elektronike (1 - 2)	9	
	Teoria e sinjaleve, Përpunimi numerik i sinjaleve	11	
	Elementë të komunikimit elektrik, Sisteme elektronike	10	
	Bazat e automatikës (1 - 2)	10	
	Baza të dhënash (1 - 2)	9	
Veprimtari në disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (C)	Llogaritësit elektronikë, Sisteme operative, Arkitektura e kompjuterave	14	14
Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D)	Lëndë me zgjedhje (Gr. 1)	5	9
	Lëndë me zgjedhje (Gr. 2)	4	
Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (E)	Gjuhë e huaj	8	22
	Elementë bazë të informatikës, Teknikë dhe gjuhë programimi	10	
	Praktika mësimore	4	
Teza e Diplomës (F)	Teza e diplomës	6	6

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:**

- Për leksionet **10-12** orë në auditor dhe **17-13** orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret **7.5-8** orë në auditor dhe **17.5-17** orë punë e pavarur e studentit

- Për Labororet **12-16** orë në auditor dhe **13-9** orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore **15-16** orë në auditor dhe **10-9** orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale **20** orë në auditor dhe **5** orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar **0** orë në auditor dhe **25** orë punë e pavarur e studentit

Planet mësimore të detajuara në vite, marëdhënien orë kredite dhe shpërndarja javore janë paraqitur në Tabelën 6 Anekse.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Duke vlerësuar gjendjen e konstatuar, planin mesimore të miratuar [Rregullore mesimore BSc. TI, [Evidencë L1-28] dhe raportin e vlerësimit të brendshëm RVB si dhe materialin në DVV [Evidencë L1-10] vërehen rishpërndarje të krediteve në 2 lëndë të vitit të parë dhe ndryshime në kredite në 4 lëndë të vitit të dytë. Ndryshimet kryesisht konsistojne në rritjen e krediteve të laboratoreve. Gjithashtu është ndryshuar kohëzgjatja e praktikës mësimore nga 2 javë në 3 javë. Ndryshimet e detajuara janë paraqitur në tabelën 7 në Aneksi 4.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Bazuar ne RVB lista e personelit akademik me lendet perkatese jepet ne Tabelën 8, Anekse.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuset për çdo lëndë përmbajnë elementët bazë të tyre, ato jane të kompletuar ne çdo aspekt. Nga analiza e tyre sipas materialit në [Evidencën L2-5] vihet re ngarkesa pak e lartë që kanë 1-2 lektorë në mbulimin e disa lëndëve në disiplina të formimit karakterizues.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset janë hartuar për çdo lëndë dhe përmbajnë këto elementë bazë:

- Emërtimi i modulit/lëndës
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Titullari dhe emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Tipi i lëndës në disiplinat A-F
- Objektivat e lëndës, njohuritë që lënda ka per qëllim të japë.
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës.
- Të gjitha temat që trajton lënda në aspektin teorik dhe praktik.
- Forma e vlerësimit të studentit
- Detyrimet e studentit
- Literatura e detyrueshme dhe ajo ndihmëse.

GVJ i shqyrtoi të gjitha syllabuset përkatëse të lëndëve të programit mësimore BSc-TI dhe rezulton se ato janë hartuar sipas formatit të kërkuar me elementët bazë të tyre. Bazuar në [Evidencë L1-10 dhe L1-11], institucioni ka riorganizuar planin mësimore dhe syllabuset përkatëse të lëndëve. Bazuar në DVV rezulton se një pjesë e mirë e syllabuseve janë rifreskuar, janë riorganizuar të gjitha lëndët e vitit të parë duke përmirësuar dukshëm cilesinë e tyre. Gjithashtu janë përmirësuar disa nga syllabuset e lëndëve të disiplinave B dhe C, *do të rekomandonim që titullaret e lëndëve të jenë staf i brendshëm efektiv*. Sa i përket përmbajtjes së tyre GVJ, vlerëson se ato japin plotësisht problematikën e lëndës duke iu përgjigjur objektivave të saj. Duke gjykuar se syllabuset janë në

proces përmirësimi të përhershëm, *GVJ rekomandon që ato të përshtaten më mirë me kërkesat e tregut, zhvillimin e vrullshëm të teknologjisë së informacionit si dhe me kërkesat e studentëve.*

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Ky program është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit, VBA nr. 43, datë 19.05.2017, për një kohëzgjatje 6 mujore, ky program përfundon me diplomën Bachelor ofrohet i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 60 kredite. Për të tre vitet e studimit, studenti duhet të grumbullojë 180 kredite që të diplomohet.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Nga takimi me studentët konstatuam se njësisia bazë (departamenti) jep informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programit të studimeve, në fillim të çdo viti akademik, nëpërmjet sekretarisë mësimore, me asistencën e asistentëve të tij dhe zyrës së zhvillimit të karrierës.</p> <p>Departamenti jep informacion të nevojshëm për lëndët me zgjedhje dhe ato të detyruara.</p> <p>Departamenti jep informacion të nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe frekuentimin e programit nëpërmjet sekretarisë mësimore.</p> <p>Syllabuset e të gjitha lëndëve u vihen në dispozicion studentëve në fillim të vitit akademik. Përmes tyre ata njihen me orët në auditor, ndarjen në leksione, seminare, laboratorë dhe praktika, detyrimet që lidhen me frekuentimin dhe detyrime të tjera që lidhen me shlyerjen e lëndës sipas programit përkatës. <i>Informacioni publikohet në fillim të vitit akademik në faqen web, (http://albaniamuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike-2/).</i></p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me misionin dhe strategjinë e AU për zhvillim duke ju përshtatur kërkesave të tregut të punës për specialistë të kualifikuar në këto fusha. Mësimdhënia zhvillohet në gjuhën shqipe duke përgatitur në këtë mënyrë specialistë të aftë për tregun kombëtar të punësimit. Realizimi i programit mbështetet nga një staf akademik i motivuar dhe me nivel të lartë shkencor. Studentët disponojnë gjithë informacionin për programin e studimit. Departamenti, sekretaria mësimore dhe asistencën e universitetit u vjen gjithmonë në ndihmë për çdo pyetje që këta të fundit ngrenë për programin e studimit, apo çështje të</p>	

tjera akademike të lidhura më këtë të fundit. Gjatë takimit me studentët është konstatuar se shërbimi ka funksionuar rregullisht dhe me korrektësi duke përmbushur nevojat që ata kanë pasur. Rekomandohet rishikimi i kurrikulave me qëllim orientimin sa më të mirë të kërkesave të studentëve me kërkesat e tregut të punës për këtë diplomë.

Standardet plotësohen plotësisht.

8. Mësimdhënia

Procesi mësimor për këtë program studimi është i organizuar në minimumi tre vite akademike, koha maksimale e studimeve është 6 vite akademike (dyfishi i afatit të rregullt) pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore dhe 6 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve. Studenti zhvillon deri në 25 orë mësimore në auditor/javë. Koha e fillimit, mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet e festave zyrtare përcaktohen në kalendarin akademik të miratuar nga Senati. Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyrat ose projekte kursi, praktikat profesionale. Numri total i veprimtarive formuese është 22, ku janë parashikuar 20 provime, 1 praktikë dhe provimi i diplomës. Departamenti, me propozimin e stafit pedagogjik dhe miratimin e Dekanit, mund të përcaktojë edhe forma të tjera të punës mësimore dhe të kontrollit të dijeve, të cilat bëhen publike për studentët në fillim të çdo viti akademik. Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje, njësoj të rëndësishme. Lëndët mund të jenë semestrale ose vjetore. Lëndët zhvillohen sipas orarit mësimor të shpallur, të ndërtuar mbi kritere pedagogjike me qëllim shpërndarjen e ngarkesës mësimore në mënyrë të balancuar. [Evidencë L1-28, neni 16, fq. 11]

Frekuentimi në punët laboratorike dhe projektet është i detyrueshëm 100 % të seancave. Për studentët që kanë munguar me arsye në jo më shumë se 25 % të seancave të rregullta të punëve laboratorike planifikohen deri në dy seanca plotësuese për çdo semestër dhe lëndë [Evidencë L1-28, neni 17, fq. 11].

Studenti nuk pranohet në sesionin e parë të provimit të një lënde kur ka kryer më shumë se 25% mungesa në seancat mësimore (leksione/seminare/ushtrime) të asaj lënde. Në qoftëse ai ka kryer deri në 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës, atëherë ai pranohet në sesionin e dytë të provimit. Nëse ka kryer mbi 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës shpallet përsëritës në atë lëndë.

Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët/ushtrimet, punët laboratorike, detyrat e kursit, projekte, etj; të organizuara në 22 module, ku janë parashikuar 20 provime, praktika dhe teza e diplomës (provimi i diplomimit).

Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje. Lëndët mund të jenë semestrale ose vjetore [Evidencë L1-28, neni 7, fq. 4].

Kontrolli i njohurive të studentëve përcaktohet në Rregulloren mësimore të programit të studimit [Evidencë L1-28, neni 27, fq. 16] dhe në syllabusin e çdo lënde (Tabela 15).

Metodat e mësimdhënies janë një ndërthurje e metodës klasike të shpjegimit në tabele me projektme të materialeve mësimore të përgatitura nga pedagogët e lëndëve.

Stafi akademik dhe procesi mësimor janë në vlerësim periodik nga ana e studentëve përmes pyetësorëve dhe nga NJSBC përmes focus grupeve.

Përfaqësuesit e studentëve janë prezent në mbledhjet e departamentit [Evidencë L1-92] dhe në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit. Ata, gjithashtu, shprehin mendimet dhe kërkesat e tyre edhe përmes përfaqësuesve në Këshillin Studentor. Kryetari i Këshillit Studentor është pjesë e Senatit Akademik.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:(sipas RVB)

Programi i Studimit <i>Bachelor</i> në Teknologji Informatike	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	1018
Seminare	34
Ushtrime	583
Laboratore	303
Detyra Kursi	13
Praktikë profesionale	80
Në total	2031

Format e kontrollit të njohurive (sipas RVB)

Raporti i kontrollit të njohurive i specifikuar në Nenin 21 të rregullores së studimit bëhet sipas tabelës së mëposhtme në varësi të shpërndarjes së krediteve të lëndëve përkatëse:

A- Lëndë me leksione/seminare/laboratore/detyrë kursi

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e seminareve	5%
Dorëzimi i detyrës së kursit	5%
Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë	10%
Provimi i ndërmjetëm/Moduli	20%
Provimi përfundimtar	60%
Gjithsej	100%

B-Lëndët me leksione/seminare

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e seminareve	10%
Dorëzimi i detyrave	10%
Provimi i ndërmjetëm/Moduli	20%
Provimi përfundimtar	60%
Gjithsej	100%

C-Lëndët me leksione/seminare/laboratore

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e seminareve	5%
Dorëzimi i detyrave	5%
Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë	10%
Provimi i ndërmjetëm/Moduli	20%
Provimi përfundimtar	60%
Gjithsej	100%

D-Lëndët me leksione/laboratore

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Dorëzimi i detyrave	5%
Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë	15%
Provimi i ndërmjetëm/Moduli	20%
Provimi përfundimtar	60%
Gjithsej	100%

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	3 ¹
Për punime shkencore individuale të studentëve	1 ¹
Për punime në konferencën studentore	6 ²
Për projekte mobiliteti në rang Departamenti	3 ³
Për projekte shkencore në rang Departamenti	-
Për projekte shkencore në rang Fakulteti	-
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	-

¹Punimet shkencore të studentëve [Evidencë L1-20].

²Pjesëmarrës në Konferencën e III Studentore, 2017 [Evidencë L1-17, 18]

³Marrëveshje Erasmus+ me Universitetin e Salernos nga e cila përfitojnë mobilitet 3 studentë dhe 1 pedagog [Evidencë L1-23].

9. Studentët

Në AU pranimit në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin nr.80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, mbi akte të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë në fuqi Në këto dy vite akademike regjistrimi i studentëve është bërë on-line nëpërmjet sistemit të MASR, më parë bëhej aplikim me dosje.

Mbështetur në RVB, renditja e kandidatëve fitues për këtë program studimi bëhet duke përdorur formulën e renditjes sipas pikëve të fituara ku: mesatarja sipas VKM zë 70%, mesatarja e gruplëndëve matematikë, informatikë dhe fizikë 30%. Nga vizita e bërë në sekretarinë mësimore të fakultetit dhe shqyrtimi i dokumentave në mënyrë rastësore për studentët dokumentat e pranimit të studentëve ishin:

- Diplomë e maturës shtetërore së bashku me certifikatën e notave
- Dëftesë e pjekurisë së shkollës së mesme(kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011)
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Dy fotografi
- Formulary i aplikimit ku ka informacion të plotë mbi studentin, emër, atësi, mbiemër, mesatare e shkollës së mesme
- Kontrata me institucionin
- Fatura e pagesës

Procedurat e pranimit të studentëve

Pranimi ne programi i studimit “Bachelor në Teknologji Informati” i drejtohet studentëve, të cilët kanë notën mesatare mbi 6 dhe kanë përfutuar njëri nga diplomat e mëposhtme:

1. Maturën shtetërore;

2. Diplomën e shkollës së mesme (të përgjithshme ose të profilizuar, sistemi i vjetër);
3. Diplomë e shkollës së mesme profesionale 5 vjeçare;
4. Dëftesa e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlefshme me të në Shqipëri.

Pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet në ciklin e I-rë të studimeve, dhe konkretisht në Programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni në Albanian University është me dosje. Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit. Shtetasit e huaj duhet të paraqesin edhe: A. Lejen e qëndrimit në Shqipëri (kopje e noterizuar); B. Dokumentin që vërteton njohjen e gjuhës së huaj (njohur ndërkombërisht) në të cilën zhvillohet programi i studimit ku regjistrohet kandidati (me përjashtim të rastit kur gjuha e huaj është gjuha zyrtare e shtetit nga vjen kandidati).

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve. Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare**

Numri i studenteve në tre vitet e fundit akademike marrë gjatë vizites ne institucion

Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë	Mesatarja në hyrje	Studentë të transferuar sipas viteve			Transferrime në total	Totali i studentëve në vitin akademik	Mesatarja në përfundim
			Vit i I	Vit i II	Vit i III			
2015-2016	33	6.89	3	1	0	4	37	5.46
2016-2017	21	6.61	2	2	9	13	34	5.62
2017-2018	16	7.01	3	2	0	5	21	5.88
Totali	70					22	92	

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare**

Viti akademik	Numri i studentëve të diplomuar pa vite përsëritëse	Nota mesatare
2016-2017	19	

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend**

Bazuar në rregulloren mësimore [Evidencë L1-28, neni 11] dhe në rregulloren e transferimeve [Evidencë L1-93], Albanian University mundëson transferimin e studentëve në vite ndërmjetëse brenda ciklit të parë, midis programeve të njëjta ose të ngjashme studimi, si brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, private ose publike, vendase ose të huaja, si dhe lejon transferimin e studentëve të saj në shkolla të tjera të arsimit të lartë.

Gjatë vitit akademik 2016 – 2017 nga programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni janë larguar 5 studentë, në vitin akademik 2017 – 2018 janë transferuar nga universitete të tjera gjithsej 5 studentë.

- Të dhëna për punësimin e studentëve**

Numri total i të diplomuarve në programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni për vitin akademik 2016 – 2017 është 28. Zyra e Karrierës dhe Alumnit përmes kontakteve telefonike, me e-mail dhe kontakteve të drejtpërdrejta me të diplomuarit, pasqyroi të dhënat e punësimit të tyre

[Evidencë L3-18], nga të cilat rezultojnë aktualisht të punësuar në përputhje me diplomën 2 të diplomuar dhe jo në përputhje me diplomën 3 të diplomuar.

Gjithsej 5 të punësuar, 9 studentë të diplomuar vazhdonin studimet Master, prej të cilëve 8 studentë ndjekin studimet Master i Shkencave pranë Albanian University.

Numri total i të diplomuarve

Periudha e të dhënave (v.a. 2016 – 2017 dhe 2017 - 2018)			
Programi i studimit BSc. në Teknologji Informacioni	Numri total të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
	28	2	3

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

➤ Në përputhje me diplomën rezultojnë 2 studentë.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

➤ Numri i të punësuarve jo në përputhje me diplomën, rezultonte 3 studentë

Nga zyra e Karrierës u ngrit shqetësimi për mungesën e përgjigjes nga ana studentëve të diplomuar (arsyeja ndryshimi i numrit të telefonit apo mos përgjigja e emailit).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj.	
Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, mbi akte të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë në fuqi	Pranimi në këtë program studimi bëhet në përputhje me Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe mbi aktet e tjera nënligjore mbi arsimin e lartë në fuqi.
Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	IAL nuk propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;	Studentët informohen në mënyrë të rregullt dhe në detaje në lidhje me programin e studimit. Aktesa e informacionit është si vijon: <ul style="list-style-type: none"> • Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve (ZKMS) • Guida studentore • Web site zyrtar i AU www.albanianuniversity.al • Zyra e karrieres • Pedagogët e moduleve.
Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;	
Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;	
Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.	Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde në përfundim të semestrit. Kriteri i vlerësimit të pedagogëve bëhet mbi bazën e mësimdhënies komunikimit dhe etikes profesionale, gjithashtu edhe departamenti bën një vlerësim të brendshëm të pedagogëve.

	Zyra e karrierës u ofron këshillim për karrierë dhe mundësi punësimi ndërmjet: panairit të karrierës, marrëveshjeve bashkëpunuese që AU ka me kompanitë e tregut dhe lidhjeve me Panairin e Punës.
Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Gjatë vizitës tek sekretaria mësimore GVJ konstatoti se AU disponon statistika për numrin e të diplomuarve dhe studentëve që pritet të diplomohen, ka statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërhequr dhe larguar para përfundimit të programit dhe mospërfundimin me sukses të vitit akademik. Nga verifikimet e kryera në sekretarinë mësimore u kontrollua në mënyrë të rastësishme dosjet e studentëve të rregjistruar, të transferuar apo që kanë ndërprerë studimet në mënyrë të njëanshme, rezultuan të rregullta. AU disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi e në vazhdim.</p>
Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor. Zyra e këshillimit të karrierës aktualisht menaxhonte dhe mbikëqyrte takimet e përcaktuara e të planifikuara të pedagogun përgjegjës me grupet e studentëve.</p> <p>Institucioni ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale. Departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës i ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit, në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, duke dërguar kërkesa të veçanta për çdo institucion brenda vendit me të cilin kishin marrëveshje bashkëpunimi.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> Nga shqyrtimi i dosjes dhe vizita në institucion GVJ konstaton se AU i informon studentët për procedurat e akreditimit të institucionit, të programeve të studimit, për procedurat e njohjes dhe vlefshmërisë së diplomave brenda dhe jashtë vendit. "Albanian University" në strukturën e tij organizative ka: Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve (ZKMS) dhe Zyrën e Karrierës (ZKA). Keto organizma punojnë për të realizuar këshillimin për karrierë dhe për të mbajtur lidhjet e institucionit me të diplomuarit. Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor, praktikën dhe kërkimin.</p> <p>AU duhet të punojë më shumë në përthithjen e studentëve të rinj me rezultate të larta, pasi kjo do të rriste edhe nivelin e brendshëm të vetë studentëve të tjerë. AU duhet të intensifikojë kontaktet në vendosjen e bashkëpunimeve edhe me kompani të mëdha të Teknologjisë së Informacionit në Shqipëri, si kompanitë mobile, kompanitë e Internetit etj, në mënyrë që studentët të integrohen në fusha edhe më të gjera të mundshme në tregun e vështirë e konkurrues të punës.</p> <p>Standardet plotësohen plotësisht</p>	

10. Kërkimi shkencor në funksion të programit

Veprimtaria kërkimore shkencore në Universitetin AU është e organizuar dhe zhvillohet në zbatim të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Ajo përqëndrohet kryesisht: në hartimin e strategjisë së kërkimit shkencor që miratohet nga Senati i Universitetit; në realizimin e kërkimit shkencor e të aplikuar bazë ose të aplikuar, studime dhe projekte për zhvillim, veprimtari të tjera krijuese sipas objektivave specifike të institucionit. Departamenti i Inxhinierive ka fituar një Erasmus+ me Universitetin e Salernos, nga e cila kanë përfituar mobilitet **1 pedagog dhe 3 studentë** [Evidencë L1-23]. Është aplikuar sërish në Erasmus+2018 me Universitetin e Kamerinos, Itali. Është aplikuar me një projekt në programin EBF me partnerë Kolegjin “Pjetër Budi”, Kosovë dhe Universitetin e Teknologjisë dhe Shkencës së Informacionit “St. Paul the Apostle”, Maqedoni, me përgjigje jo pozitive [Evidencë L1-24]. Është nënshkruar një marrëveshje me rrjetin Italian NetC0 [Evidencë L1-25], me të cilin janë programuar një sërë aktiviteteve akademike dhe kërkimore shkencore. Veprimtaria e parë në kuadër të kësaj marrëveshjeje pritet të jetë organizimi i Javës Europiane të Energjisë së Qëndrueshme – EUSEW 2018. Në Shtator 2018, Departamenti është i angazhuar në organizimin e Konferencës së 14-të Ndërkombëtare “Standardization, Prototypes and Quality: A Means of Balkan Countries’ Collaboration”, duke qenë edhe organizatori kryesor së bashku me Organizatën Shqiptare për Cilësinë - AOQ [Evidencë L1-26]. Institucioni bashkëpunon me organizatën zvicerane Swiss EP [Evidencë L1-22] dhe po punon në drejtim të ngritjes së një inkubatori të teknologjisë, për t’i dhënë mundësinë studentëve të talentuar për të realizuar idetë e tyre në realizimin e produkteve teknologjike. Në 22 dhjetor 2017, u mbajt Konferenca e IV Ndërkombëtare “Problems and Challenges of Transformation of the Society towards Standards of the European Union Conference” organizuar nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në bashkëpunim me Kolegjin Universitar Qirjazi, Universitetin Bujqësor dhe Universiteti La Sapienza, Romë. Në të morën pjesë 10 pedagogë nga Departamenti i Inxhinierive me 9 punime dhe 1 student me punimin e tij [Evidencë L1-95].

Tregues të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit(sipas RVB)

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang programi studimi, në vitet e fundit		
1	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL	34
2	Numri i projekteve kërkimore të fituara	0
3	Numri i projekteve të zbatuara	3
4	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL, për programin e studimit	2
5	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL	10
6	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	2
7	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	12
8	Numri i Çmimeve Kombëtare	0

Rekomandim: Staf i brendshëm duhet të bëjë më shumë për kualifikimin e tij. Të rrisë numrin e botimeve shkencore brenda vendit dhe jashtë tij, gjithashtu edhe departamenti duhet të rrisë përpjekjet e tij në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe të mbështesë stafin e kualifikuar në lehtësira ekonomike.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Albanian University në strategjinë e vetë të zhvillimit ka si prioritet konsolidimin në tregun vendas, të vendosjes së marrëdhënieve me stafin akademik efektiv dhe të jashtëm, me konsolidimin e planit mësimor, të kryerjes së praktikave profesionale. Institucioni ka marrëveshje institucionale me 4 universitete, me të cilët Departamenti i Inxhinierive ka shkëmbim stafi në kuadër të mësimdhënies me: [Evidencë L1-98, L1-99, L1-100; L1-103].

- Universitetit Politeknik i Tiranës
- Universitetin Bujqësor të Tiranës
- Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu”
- Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Departamenti i Inxhinierive bashkëpunon me kompaninë italiane NetC0 me të cilën parashikon organizimin në qershor 2018 të Javës Europiane të Energjisë së Qëndrueshme – EUSEW 2018 [Evidencë L1-25].

Departamenti bashkëpunon me organizatën zvicerane Swiss EP [Evidencë L1-22] me të cilën po punon në drejtim të ngritjes së një inkubatori të teknologjisë, për t'i dhënë mundësinë studentëve të talentuar për të realizuar idetë e tyre në realizimin e produkteve teknologjike.

Mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura:

Departamenti i Inxhinierive ka një marrëveshje shkëmbimi të stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus+ 2017 me Universitetin e Salernos [Evidencë L1-23]. Nga ky program përfitojnë mobilitet 1 pedagog dhe 3 studentë të departamentit.

Pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare:

Aktualisht, nuk ka pjesëmarrje aktive në programe kombëtare. Po punohet me fokus në këtë drejtim. Departamenti i Inxhinierive është pjesë e programit Erasmus+ 2017 me Universitetin e Salernos [Evidencë L1-23].

Lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës:

Ka një marrëdhënie të bollshme me kompani shqiptare të tregut, ku studentët kryejnë praktikat mësimore dhe kanë mundësi punësimi.

Tregues të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (sipas RVB)

Aktivitete shkencore individuale dhe në rang Programi studimi në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në vitet e fundit		
1	Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte kombëtare apo ndërkombëtare	1
2	Numri i leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj (ose orë mësimore)	6
3	Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	1
4	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit	3
5	Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	10
6	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/jashtë vendit dhe prezantime	0
7	Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	0

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>AU, Fakulteti Shkencave të Aplikuara nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit dhe shkëmbimin e informacionit në forma të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkëmbimit të informacionit, diskutim në mbledhje departamenti. • Vlerësim të punës dhe matjes së performancës së secilit pedagog. <p>Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimit nëpërmjet ndarjes së detyrave që përcaktohen edhe në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe gjatë vizitës në institucion rezulton se institucioni për realizimin e objektivave të programeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me aktorët e biznesit vendas dhe të huaj.</p> <p>Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p> <p>GVJ konstaton se institucioni nuk ka organizuar trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e tij të diplomuar, ndaj dhe ky kriter ka vend për t'u përmirësuar në të ardhmen.</p> <p>Nuk ka një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale. Universiteti duhet të shtrijë fushat me kompani më të mëdha të Teknologjisë së Informacionit për mbarëvajtjen e praktikës profesionale dhe punësimit në të ardhmën të studentëve.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Nga verifikimet e bëra konkludojmë se Universiteti AU bashkëpunon me institucionet publike dhe private në kuadër të praktikave mësimore duke plotësuar kriteret VII.1 dhe VII.2</p> <p>AU duhet të fuqizojë marrëveshjet me aktor potencial të fushës së teknologjisë së informacionit me qëllim të vendosjes së marrëdhënieve të qëndrueshme afatgjata.</p> <p>Rekomandohet zgjerimi i marrëveshjeve bashkëpunuese për qëllimin e praktikave edhe të projekteve, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të punojnë me teknologjinë e përditësuar në të ardhmen.</p> <p>Standardet plotësohen plotësisht</p>	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Rekomandimi a) *Të përmirësohet cilësia e studentëve të pranuar në këtë program studimi.*

Cilësia e studentëve në programet e studimit Bachelor është përmirësuar. U arrit që në vitin e parë të vitit akademik 2017 – 2018 nota mesatare hyrëse ishte 7.01.

Rekomandimi b) *Të shtohet aktiviteti shkencor i Departamentit.*

Nga ana e Departamentit të Inxhinierive janë bërë përpjekje sinjifikative në drejtim të rritjes së aktivitetit kërkimor nëpërmjet nxitjes dhe mbështetjes së stafit konkretizuar në aplikime në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Në të gjitha këto veprimtari AU ka vendosur në dispozicion jo vetëm logjistikën, por edhe mbështetjen e nevojshme financiare.

Rekomandimi c) *Të shtohet bashkëpunimi me punëdhënës lokalë me qëllim kryerjen e praktikave të studentëve në institucione të specializuara në fushën e teknologjisë së informacionit.*

Gjatë vitit akademik 2017 – 2018, Departamenti i Inxhinierive ka nënshkruar 7 marrëveshje të reja në kuadër të praktikave mësimore, 4 prej tyre janë të orientuara në fushën e teknologjisë së informacionit.

Rekomandimi d) *Të rritet bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë brenda vendit.*

Janë nënshkruar marrëveshje me pesë institucione të arsimit të lartë në vend me të cilat Departamenti i Inxhinierive ka shkëmbim të drejtëpërdrejtë stafi ose bashkëpunim në kuadër të eventeve të përbashkëta si dhe një marrëveshje bashkëpunimi me një institucion arsimor në Kosovë.

Në konkluzion, **rekomandimet** e Bordit të Akreditimit janë plotësuar dhe i kanë shërbyer përmirësimit të cilësisë së aktivitetit mësimor dhe kërkimor në shërbim të Programit të Studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” të AU. Është e rëndësishme që plotësimi i këtyre rekomandimeve të ndiqet edhe në vitet në vijim.

II. ANALIZA SWOT

a. Pika të forta:

1. Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” është në përputhje me standardet kombëtare si dhe misionin dhe objektivat strategjikë të AU;
2. AU ndjek procedurë të përcaktuara qartë për sa i përket punëmarrjes së një personeli akademik efektiv dhe me kontratë cilësor;
3. Departamenti në bashkëpunim me NJSBC është i angazhuar në vlerësimin e vazhdueshëm të performancës së stafit akademik dhe atij administrativ.
4. Departamenti është i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në rishikimin e kurrikulave në përputhje me nevojat e tregut dhe azhurnimet më të fundit të teknologjisë në fushat përkatëse.
5. Disponimi i laboratorëve bashkëkohorë të përdorur në procesin mësimor;
6. Përdorimi i teknologjisë moderne në procesin e mësimdhënies;
7. Staf mbështetës i përkushtuar.

b. Pika të dobëta:

1. Ngarkesa e lartë mësimore që kanë disa pedagogë efektivë në programin e studimit;
2. Titullarët e lëndëve në një numër rastesh janë anëtarë të personelit akademik me kontratë
3. Numër i madh lëndësh i zhvilluar nga pedagogët efektivë;
4. Aktivitet kërkimor relativisht i kufizuar i personelit akademik.
5. Marrëdhënia e paqëndrueshme me institucionet pranë të cilave zhvillohen praktikat mësimore.

c. Mundësitë:

1. Rritja e bashkëpunimit me institucionet homologe universitare jashtë vendit me qëllim shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve si dhe në drejtim të kërkimit shkencor;
2. Zgjerimi i mëtejshëm, si nga larmia ashtu edhe nga tirazhi, i literaturës shkencore vendase dhe të huaj në bibliotekë në shërbim të programit të studimit;
3. Hartimi i programeve të plota të kërkimit shkencor dhe zgjerimi i pjesmarrjes në projekte kërkimi në funksion të kërkesave të ekonomisë;
4. Rritja e vetëdijes së stafit dhe studentëve për rëndësinë e sigurimit të cilësisë;
5. Rritja e kërkesës për të diplomuar cilësorë në fushën e teknologjisë së informacionit;
6. Intensifikimi i përpjekjeve për rritjen e numrit dhe cilësinë e studentëve të pranuar.
7. Zhvillimi i marrëveshjeve të qëndrueshme me institucione shtetërore apo kompani private në kuadër të zhvillimit të praktikave mësimore;
8. Ofrimi i shërbimeve për të tretët.

d. Pengesat:

1. Vështirësitë për sigurimin e personelit akademik efektiv me kualifikimin e kërkuar;
2. Vështirësi për angazhimin e personelit akademik efektiv në kërkimin shkencor për arsye në numrit të madh të lëndëve të zhvilluara dhe ngarkesës mësimore relativisht të madhe;
3. Numri i madh i institucioneve homologe në Shqipëri që formojnë specialistë në fushën e Teknologjisë së Informacionit.
4. Mungesa e eksperiencës së stafit akademik në aplikime në projekte.
5. Institucionet pranë të cilave zhvillohen praktikat mësimore nuk janë në vazhdimësi të disponueshme për kryerjen e praktikave mësimore pranë tyre.

(SWOT ANALYSIS)

a. Strengths:

